

K O M E N T

Pershendetje.

Me VKM nr.1025 date 16.12.2020 paga minimale per vitin 2021 ka ndryshuar nga 24.000 leke ne 30.000 leke

Paga maksimale, ne baze te ligjit 7703 date 11.05.1993 neni 10 “Masa e Kontributit, indeksohet në të njëjtën kohë dhe në atë masë që indeksohet paga minimale në shkallë vendi.

Mbi kete baze kemi:

Paga minimale ishte 26.000 leke - behet 30.000 leke - rritja 4.000 leke ose 15.38462 %

Paga maksimale ishte 114.671 leke - behet 132.313 leke - rritja 17.642 leke ose 15.38462%

Perfundimisht kufijte e pages per llogaritjen e kontributit te sigurimeve shoqerore per vitin 2021 do te jene:

Paga minimale 30.000 leke

Paga maksimale 132.313 leke

Ligji 7703, datë 11.5.1993

Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë

Neni 10

Masa e kontributeve

Kontributi që paguhet për sigurimet shoqërore në fondet e sigurimeve për sëmundje, barrë lindje dhe pensione do të jetë:

a) për punëdhënësit 13,8 për qind e shumës bruto të listëpagesave;

b) per personin e punësuar 9,5 për qind e pagesës së tij totale (bruto);

*Kontributi llogaritet dhe paguhet mbi pagën bruto, brenda kufijve të pagës minimale në shkallë vendi dhe pagës maksimale për efekt kontributi për sigurimet shoqërore, miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave, e cila është në fuqi në datën 31.12.2014. Pas datës 1.1.2015, **paga maksimale për efekt kontributi indeksohet në të njëjtën kohë dhe në atë masë që indeksohet paga minimale në shkallë vendi.***

Kontributi minimal për personin e punësuar, punëdhënësin dhe të vetëpunësuarin është i barabartë dhe llogaritet mbi bazën e pagës minimale në shkallë vendi.

Personat e vetëpunësuar në bujqësi paguajnë kontribut për pension dhe barrë lindje të llogaritur mbi pagën minimale në shkallë vendi. Pagesa e kontributit bëhet çdo tremujor.

Ndryshuar neni me ligjin nr.104/2014 date 31.07.2014